



I gatshëm për shkollë

Për çfarë kanë nevojë
fëmijët e vegjël nga
prindërit

Erziehungsberatung
Erziehungsdirektion des Kantons Bern
Sulgeneckstrasse 70
3005 Bern

Telefon 031 633 85 11
www.erz.be.ch/fit-fuer-die-schule



Të dashur prindër

Fëmija juaj është në mes moshës dy dhe gjashtë vjeçare dhe nganjëherë ju lind pyetja se sa do të jetë i përgatitur dhe i gatshëm për jetën, për kopshtin dhe për shkollën?

Në shoqërinë tonë, shkolla është për të gjithë fëmijët një ofertë e pasur dhe shumë e rëndësishme zhvillimi. Ajo është një e drejtë por edhe një detyrim - të gjithë fëmijët hyjnë në shkollë. Organizimi i të mësuarit në grupe, do të jetë i lehtë për ata fëmijë, të cilët do të jenë të parapërgatitur për një gjë të tillë.

Ju si prindër keni shumë ndikim tek fëmija juaj, prandaj që tani keni mundësi të bëni diç rreth kësaj! Nga përvoja jonë si specialistë të psikologjisë së fëmijëve do t'ju prekim në zemër me disa propozime.

Fëmijëve u nevojiten:

Siguria

një lidhje e sigurtë dhe besueshmëri, si dhe një marrëdhënie plot dashuri në familjen e tyre;

Përvojat

përvojat e gjalla dhe detyrat e përditshme, në të cilat marrin pjesë që nga vogëlia dhe mund t'i ruajnë;

Idhjet

një rreth social me fëmijët tjerë dhe të rriturit, në të cilin mund të bëhen të vetëdijshëm për veten dhe për të tjerët.

Fëmijëve u nevojitet gjuha

Gjuha hap rrugën për tek të tjerët dhe për të mësuar. Ajo fillon që në fëmijëri të hershme të ndërmjetësojë në familje. Me gjuhën fëmijët fillojnë të formojnë marrëdhënie. Ata mësojnë se si duhet të flitet me një fëmijë dhe se si duhet të flitet me një person të rritur. Ose tjetra, ata bëjnë përvojë që nëpërmjet gjuhës t'i zgjidhin konfliktet.

Gjuha duhet të mësohet dhe kultivohet. Fëmijëve u pëlqejnë lojërat gjuhësore. Ata provojnë tingujt dhe zërat e sajuar me fjalë qesharake të ndara, të pakuptimta me rrokje, i testojnë domethëniet ose zakonet kohë pas kohe edhe me „fjalë të këqija“ që të sprovujnë efektin (ndikimin) tek të rriturit.

Me gjuhë fëmijët shoqërohen dhe përcillen nga prindërit. Fëmijët mësohen të dëgjojnë, të dëgohen nga të tjerët dhe të jenë bashkëpjesëmarrës. Rregullat e bashkëjetesës vendosen nëpërmjet gjuhës. E thëna duhet të dëgjohet dhe të kuptohet. Çfarë thuhet është e vlefshme.


Gjuha është një thesar me plot vlera, të cilin ua jepni fëmijëve tuaj gjatë jetës.



Mësimi dhe kultivimi i gjuhës

Të folurit

Flisni shumë me fëmijën tuaj edhe nëse ai është i vogël dhe akoma nuk flet vetë. Ai megjithatë kupton shumë. Fëmijët fare të vegjël ndjekin melodinë e gjuhës dhe japin sipas mënyrës së tyre përgjigje. Format e para të një bisede veç janë të pranishme. Bashkëbisedimi do të thotë më shumë se sa ndërmjetësimi në informata.



Keni parasysh që me fëmijën tuaj të flisni me qetësi dhe fjalë të qarta; shmangjuni mallkimeve dhe sharjeve të rënda.

Të folurit nuk mësohet nga televizori. Të shikuarit shumë të televizorit dhe qëndrimi i gjatë para kompjuterit dëmtojnë gjuhën.

Të dëgjuarit

Dëgjojeni me vëmendje kur flet fëmija juaj. Kushtojani kohën ta dëgjoni. Nëse i tregoni diç fëmijës tuaj, vërtetoheni nëse ju ka dëgjuar ose kuptuar.

Të treguarit

Në qoftë se fëmijës tuaj i tregoni përalla, shikoni me të libra me fotografi, këndon me të këngë dhe recitoni vjersha, tek ai zgjoni dashurinë për gjuhën dhe krijoni lidhje me të.

Përbushja e detyrave, shtyrja e nevojave

Formimi i shprehive të mira

Në jetën e përditshme të një familjeje janë të vendosura disa çështje që qëndrojnë si të tilla. Disa prej të cilave bile menjëherë dhe dhe pa diskutim duhet përmbushur, siç janë: larja e duarve para ngrënies; përgatitja për të bërë blerjen; ndërprerja e një loje të këndshme dhe përgatitja për shtrat e të ngjashme.

Ndihma e përbashkët

Jepni që herët fëmijës tuaj detyra të vogla, detyra të cilat mund t'i përmbushë bashkë me ju. Këtu nevojitet ndihmë dhe lëvdata. Së pari me kohën fëmija ka mundësi të mësojë detyrat e veta: t'i mbulojë pjesët e tavolinës, të mbajë rregull, të bëjë ndihmë të vogël.

Pritja

Ka vetëm pak nevoja dhe dëshira të fëmijëve të cilat duhet të përmbushen menjëherë. Të gjithë duhet të mësojnë të presin: të dëgjojnë derisa të tjerët nuk kanë përfunduar së foluri; së pari të hanë, nëse është koha; të shikojnë televizor sipas programit të përshtatshëm. Të gjitha këto mësimet janë shumë të rëndësishme për fëmijën, edhe në qoftë se ai proteston.

Përpjekja

Të mësuarit është shpeshherë i mundimshëm, rruga mund të jetë e gjatë: shumë gjëra duhet të çohen deri në fund. Ndihmonie fëmijën tuaj këtu në çdo rast. Shtrëngoni nganjëherë dhëmbët, në mënyrë që të mbani qëndrim kjo të kuptohet se duhet ndërmarrë diçka dhe të jetë një përvojë e mirë.




Mbështetë fjalën mjaft, thuaj mjaft!

Thuaj jo

Tregoni fëmijëve tuaj se ka kufij. Me këtë ju u jepni siguri, orientim dhe mbështetje. Fëmijët tuaj kanë nevojë për rregulla, në mënyrë që të rregullojnë bashkëjetesën. Të thuash „jo“ nuk dëmton asgjë, por është një dëshmi dashurie e prindërve ndaj fëmijës. Për shembull, mos i jepni gjë fëmijës tuaj në një shtëpi mallrash edhe në qoftë se ai duke ulëritur zhgryhet përtokë. Fëmija juaj do ta ketë më lehtë në të ardhmen, në qoftë se që herët ka mësuar, të tërhiqet nga diçka ose t'i tejkalojë zhgënjimet.

Si u them fëmijëve të mi?

Të flisni vetëm nuk mjafton shpesh. Drejtonie fëmijën tuaj me kërkesa e veprime të qarta dhe të kuptueshme, në mënyrë që ai t'i pranojë dhe t'i vë në jetë rregullat. Qëndroni në pozicionin sy më sy me fëmijën tuaj kur doni t'i bëni një vërejtje ose t'i thuani „jo“ për diçka, gjithmonë me një ton të butë dhe të ulët. Ju mund ndonjëherë edhe ta shkundni lehtë, kur flisni me të, kështu ai e kupton më mirë se kjo çfarë po i thoni e keni seriozisht. Dënimet fizike dhe kërcënimet masive si për shembull kundërshtimet (ndalimet) e dashurisë - i ngarkojnë raportet në mes fëmijëve dhe prindërve dhe nuk denoncohen në asnjë mënyrë.



Besojuni fëmijëve tuaj diçka! Nxitja për guxim formon guximin!

Fëmijët kuptojnë sipas përvojës personale. Këtu kanë nevojë për besimin e prindërve të tyre si dhe rastet për të provuar gjërat e reja dhe poashtu për të bërë gabime. Kujdesi i tepruar dhe frika u krijojnë pasiguri dhe u marrin vetë-besimin fëmijëve. Secili fëmijë është aktiv në shumë forma, në qoftë se ndjehet mirë dhe është i sigurtë në situata.

Pjesëmarrja, loja dhe pushimi

- Jepjuni pjesëmarrësve në lojë, pra fëmijëve, hapësirë të nevojshme: një hapësirë të papenguar; mbrojtje nga rreziqet; mbani larg nga pengesat e dukshme si dhe rrahjet e dyanshme.
- Fëmija juaj është vetë kreativ, provon dhe zbulon: mos ndërhyri në lojën e fëmijës, në përjashtim të kalimit të kufijve ose kur ju pyesin.
- Nganjëherë fëmijët mërziten. Lëreni fëmijën tuaj të mësohet me mërzitjen; mos u shqetësoni gjithmonë për sjelljet e tij.
- Secili fëmijë, edhe në qoftë se ka motra e vëllezër, duhet të ketë kohë çdo ditë, të luajë vetëm për vete, që të qetësohet. Jo që nga fillimi e deri në fund duhet të jetë gjithçka e saktë.
- Shikoni fëmijët në lojërat e tyre një herë në gjysmë dite. Më shumë nuk ka nevojë. Në kohën e mbetur ata mund t'i fusni në aktivitetet tuaja: në mbledhjen e pluhurave, në gatim, në blerje etj. Fëmija drejtohet nga ju dhe jo e kundërta!



Lojërat në grupin e fëmijëve

Unë dhe ti

Loja me fëmijët tjerë është shumë e rëndësishme për një zhvillim të shëndoshë social. Në lojën e rregullt me moshatarët, fëmija e provon ndikimin e tij tek të tjerët. Ai ushtron të shkojë me të tjerët, të hyjë apo të qëndrojë i tërhequr. Bile për fëmijët e vegjël është e mundur të krijojnë shoqërinë e parë.



Inati, zhgënjimi dhe pajtimi

Në lojën e përbashkët ka mendime të ndryshme. Fëmijët e vegjël nuk gjejnë tjetër rrugë, pos rrugës së tyre dhe ndjehen shpejt të zhgënjyer, të pafuqishëm ose të inatosur. Në shumicën e rasteve fëmijët prap bashkohen dhe lozin më tutje të kënaqur. Nëpërmjet pranisë tuaj jepini fëmijës tuaj siguri dhe mbështetje, ngushëllojeni, ndihmojeni ta kalojë zemërimin dhe bëjeni prap atë të guximshëm.

Njëherë unë e njëherë ti

Fëmijët mësojnë nga njëri-tjetri, se si është, të jesh një herë më i forti dhe një here tjetër më i dobëti, si të ngrisë zërin një herë dhe si të jetë nën urdhërat e të tjerëve pastaj, një herë të fitojë dhe një herë të humbë në grupin e fëmijëve. Fëmija juaj gjithashtu duhet të mësojë të kërkojë falje, nëse ka bërë një të keqe.

Fëmija juaj takohet me njerëz dhe situata të ndryshme. Tregoni atij se duhet të luajë me shumë veta dhe të gjithë mund t'i respektojë.

Të rriturit janë shembull

Të jesh prind do të thotë të paraprijsh, të bësh diçka, të tregosh, të thuash të përjetosh. Fëmija juaj ju përcjell përditë shumë mirë në çdo hap që bëni. Ai ju dëgjon mirë dhe e bën atë që bëni ju. Ai shikon tek ju dhe don t'ju imitojë se çfarë mund të bëj. Kështu mësojnë fëmijët në vitet e para të jetës të përgjithshmet dhe kryesoret për tërë jetën. Ata jetojnë jetën ashtu siç e ka jetuar personi i dashur përgjegjës para tij.

Ata mësojnë, për shembull se si duhet të përsëritet kur zgjohen në mëngjes dhe në mbrëmje të dëshirojnë mbrëmje të mirë para fjetjes. Ata mësojnë se si të kënaqen me njëri-tjetrin, se si të grinden njëri me tjetrin dhe prap të pajtohen. Ata mësojnë se kur është njeriu i lumtur dhe kur i mërzitur. Ata mësojnë se ç'është humori dhe ç'është serioziteti. Ata mësojnë se si të gjenden në situata të rënda dhe situata të mira dhe si mund të bëhet njeriu i lumtur. Shembujt e mirë u japin fëmijëve siguri dhe një vetëbesim të mirë.

Kënaquni në këtë kohë të shkurtër, në të cilën fëmija juaj ka nevojë shumë për ju dhe ka mundësi të mësojë shumë nga ju.

Ne ju dëshirojmë çaste të këndshme me fëmijët tuaj.

Këshillimorja juaj për Edukim e Kantonit të Bernit

www.erz.be.ch/fit-fuer-die-schule

